



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 351 Prot.

Tiranë, më 11.05 2015

**VENDIM Nr. 36, datë 13.05.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 46, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, të datës 13.05.2015, pasi shqyrtoi "*Relacionin mbi gjetjet rastësore të zbuluara si rezultat i punimeve bujqësore në fshatin Krahës-Tepelenë*", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Gjirokastrë,

**VENDOSI:**

- I. Të kryhet gërmimi i pjesës së mbetur pa gërmuar nga varri Nr. 1 dhe Nr. 2 nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Gjirokastrë; të bëhet dokumentimi i plotë i varreve dhe mbulimi i tyre, me qëllim shmangjen e dëmtimeve të mëtejshme të varreve përreth.
- II. Raporti i rezultateve të gërmimit, dokumentimit dhe mbulimit të paraqitet në KKA e radhës.
- III. Pas shqyrtimit të rezultateve të Raportit të sipërcituar në KKA, për zonën në fshatin Krahës-Tepelenë ku janë identifikuar gjetje rastësore, në varësi të potencialit arkeologjik ASHA në bashkëpunim me DRKK Gjirokastrë dhe institucionet përkatëse, të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e saj "Zonë e mbrojtur".
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO-FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**